[*Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik, kur kërkohet nga autoriteti kontraktor*]

**FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS[1]**

[Data _______]

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

Në emer të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[ objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]/ Nr.references ne faqen e APP-se*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [*emri i ofertuesit të siguruar*] ka derdhur një depozitë pranë [*emri dhe adresa e bankës / kompanisë së sigurimit*] me një vlerë prej [*monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra*] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti kontraktor e kerkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontrates së përcaktuar nëdokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [*njoftimin e kontratës ose ftesën për tender*].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

**Shtojca7**

**LISTA E INFORMACIONIT KONFIDENCIAL**

[*Shtojcë për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

(Shënoni më poshtë informacionin që dëshironi të mbahet konfidencial)

| Lloji, natyra e informacionit që duhet të mbetet konfidencial | Numri i faqes dhe pikat e DT që dëshironi të mbeten konfidenciale | Arsyet pse ky informacion duhet të mbetet konfidencial | Afati kohor që ky informacion të mbetet konfidencial |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |

**KUJDES**

Çdo e dhënë, që nuk është regjstruar si e dhënë konfidenciale, do të konsiderohet se titullari i këtyre të drejtave ka dhënë vetë pëlqimin për dhënien e informacionit përkatës dhe Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për publikimin e këtij informacioni.

Nuk përbën sekret tregtar informacioni, që duhet të bëhet publik në bazë të ligjit, që lidhet me shkeljen e ligjit, apo që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare e parimeve të etikës tregtare.Përhapja e këtij informacioni vlerësohet e ligjshme, nëse nëpërmjet këtij akti synohet të mbrohet interesi publik.

**Përfaqësuesi i ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

**Shtojca 8**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

**DEKLARATË**
**Mbi konfliktin e interesave**

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë ________________ nga Autoriteti Kontraktor________________ me objekt ____________ me fond limit __________.

Konflikt i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejpërdrejtë ose të tërthortë që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike.

Në zbatim të nenit 21 pika 1 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve përcaktuar në Kreun III, Seksioni II, që iu ndalohet në mënyrë absolute të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga lidhja e kontratave me një palë një institucion publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, zvkryeministri, ministrat, ose zvministrat, Deputetet, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët e Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit, Avokati i Popullit, Anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Anëtarët e Enteve Rregullatore, (Këshilli i Mbikqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; mediave), Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barazvlefshëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm, titullarët e institucioneve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

  Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues sipas nenit 31, dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut të III, seksioni 2 të këtj ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.**

Unë i nënshkruari ____________________, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik _______________deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** te Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës ________________

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

**____________________________**

Vula

**Shtojca 9**

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

**DEKLARATË**
**Mbi disponueshmërinë e anëtarit tëstafit tëkonsulentit[1]**

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _________________ nga Autoriteti Kontraktor________________ me objekt ____________ me fond limit __________.

Në bazë të parashikimeve të neneve 28 dhe37tëVKMNr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", të ndryshuar, Unë i nënshkruari _____________________, në cilësinë e anëtarit të stafit të Konsulentit "..............................................." për procedurën e prokurimit me objekt______________ nën përgjegjësinë time personale, ***Deklaroj***se:

1. Autorizoj VETËM Konsulentin "…………………………………..'' të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _________________ nga Autoriteti Kontraktor________________ me objekt ____________ me fond limit __________.

Deklarimi i personit tim, si anëtaristafit nga ana e çdo konsulenti tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt ………………………………………………………., është i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

3. Nuk ndodhem në kushtet e konfliktit të interesit, ***me asnjë*** nga anëtarët e stafit të autoritetit kontraktor, drejtpërdrejtë ose jo, i përfshirë në ndonjë pjesë të përgatitjes së kushteve të kontratës dhe/ose në procesin e përzgjedhjes për këtë kontratë dhe/ose për mbikëqyrjen e kësaj kontrate.

Data e dorëzimit të deklaratës ________________

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

Vula

**Shtojca 10**

**1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat jo Fitimprurëse".
b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 11.**

**Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, seicili prej anëtarëve të bashkimit duhet të dorëzojë vetdeklarimet, sipas kësaj Shtojce.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë,duhet te dorezohen:**

**a.**Marrëveshja e noterizuar, sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht[1];

**b.** Prokura e posaçme.

**2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit, sipas Shtojcës 8;*
*b. Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit të konsulentit, sipas Shtojcës 9;*
*c. Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*
d. *Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojces 11/1:*

**2.1**Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

**Kapaciteti Ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:**

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme, sipas shtojcës 11

**2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

Persa i perket kapacitetit ekonomik dhe financiare, kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat minimale:

**1.Taksat vendore:** Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin, 2019 sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për *sistemin e taksave vendore*" (i ndryshuar) dhe VKB Nr. 28, datë 24.03.2020 "Për krijimin e lehtësirave fiskale ndaj biznesit dhe shtyrjen e afateve te aplikimit për programet sociale të strehimit në kuadër të masave për parandalimin e përhapjes së infeksionit Covid-19".

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësia Administrative ose Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKR).

**2.Bilanci:** Referuar Aktit Normativ nr. 10, datë 26.03.2020, të publikuar në Fletoren Zyrtare nr.52, datë 26.03.2020, ku parashikohet ndër të tjera shtyrja e afatit për dorëzimin e bilanceve për vitin 2019, deri në 31 **Korrik të vitit 2020**. OE duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të 2 (dy) viteve të fundit ushtrimore (**2017, 2018**) të paraqitura në autoritet përkatëse përkatëse Dega e Tatim Taksave, të konfirmuara nga ky autoritet.

3.**Xhiro:** Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Administrata Tatimore/Vërtetim të gjeneruar dhe vulosur me anë të një proçedure automatike nga një sistem elektronik për xhiron mesatare vjetore të realizuar gjatë dy viteve të fundit financiare **(2018, 2019**) nga data e zhvillimit te tenderit lëshuar nga autoriteti përkatës, e cila duhet të jetësa vlera e fondit limit perkatesisht**:3.544.814 (tre milion e pesëqind e dyzet e katër mijë e tetëqind e katërmbëdhjetë )lekë pa tvsh.**

**2.3 Për kapacitetin teknik:**

**Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:**

Shërbime të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit, nga data e zhvillimit te tenderit, me vlerë 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht **1.417.925,6 (**një milion e katërqind e shtatëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzet e pesë presje gjashtë**) lekë pa tvsh.**

**a.**Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur kontratën përkatëse, vërtetim për realizimin e plotë dhe te suksesshëm të kesaj kontrate.

**b.**Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore perkatese, ku *shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

**3.Liçensa profesionale lidhur me shërbimet objekt i kontratës**:

**Liçensa profesionale të shoqërisë ( e vlefshme) për projektim (leshuar nga MZHUT ose nga Institucioni i Autorizuar sipas legjslacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studimit e projektimit në ndërtim), ku të përfshihen kategorite:**

- ***2/ç)** Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbërta, lulishte e parqe.*
- **4 i)***Projektimi i ndricimit rrugor, shesheve,dekorativ,ndricimit të objekteve të mëdha sportive, porteve e aeroporteve etj*

- ***5 b)*** *Furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi*
- ***5 c)*** *Ujësjellës kanalizime urbane-rurale.*
- ***6/a****(Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.)*
- ***8/a****(Rivelime inxhinierike.)*
- **8 c)** Sisteme GIS
- ***9/a (*** *Studim/Vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objektet civile – ekonomike deri 5 kate)*
- ***10/e*** *Kabina elektrike të rrjetit shpërndarës – linja të tensionit të ulët- mesëm.*
- ***11/a*** *(Sinjalistikë jo ndriçuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore, sheshe e parkime)*
- **11 d)** Sinjalistikë ndriçuese në infrastrukturë.

*(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).*

*Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave 'Për licencimin professional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim", Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë* **Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (leshuar nga MZHUT** ose institucione të tjera të autorizuara sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e liçensave profesionale në fushën e studim projektimit në ndërtim**)**, *e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.*

**3.1 Operatori ekonomik duhet te paraqese Licencat profesionale te stafit kryesor përgjegjës për zbatimin e kontratës ne kategorite si me poshte shenuar, kontratat individuale te punes (të vlefshme), diplome, CV, dhe stafi i mëposhtëm :**

- ***PROJEKTUES ARKITEKT*** *Kat 2. ç) Projektim peisazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbërta, lulishte e parqe.*

- ***PROJEKTUES INSTALATOR*** *Kat 4 i) Projektimi i ndricimit rrugor, shesheve,dekorativ,ndricimit të objekteve të mëdha sportive, porteve e aeroporteve etj.,*

- ***PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE*** *Kat 5. c) Ujësjellës kanalizime urbane-rurale.*5/b- Furnizim me ujë - kolektorë shkarkimi*5 c)* Ujësjellës kanalizime urbane-rurale.

- ***PROJEKTUES RRUGE-HEKURUDHA*** *Kat 6.a) Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.*

- ***PROJEKTUES GJEODET Kat 8****. a) Rilevime inxhinierike*8 c) Sisteme GIS.

- **GJEOLOG/HIDROGJEOLOG** Kat 9 a) Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile - ekonomike deri 5 kate

- ***PROJEKTIM I IMPIANTËVE TË PRODHIMIT DHE SHPËRNDARJES SË***

***ENERGJISË ELEKTRIKE Kat** 10.e) Kabina elektrike të rrjetit shpërndarës – linja të tensionit të ulët-*

- ***PROJEKTUES TË SINJALIZIMIT RRUGOR Kat* 11** a) Sinjalistikë jondriçuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe e parkime.**11 d)** Sinjalistikë ndriçuese në infrastrukturë.

***Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.***

**4.** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar në stafin e shoqërisë së tij:

- 1 (një) Ekspert për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të sipërcituar operatori ekonomik duhet të paraqesë diplomën, kontratën individuale të punës ( të vlefshme), si dhe çertifikatën për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

**5**. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar në stafin e shoqërisë së tij:

- 1 (një) Ekspert për mbrojtjen nga zjarri.

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të sipërcituar operatori ekonomik duhet të paraqesë diplomën, kontratën individuale të punës ( të vlefshme), si dhe çertifikatën për mbrojtjen nga zjarri.

**6.Një punësim mesatar i të paktën 10 (dhjetë) personave për periudhën Dhjetor 2019 - Maj 2020 të vërtetuar me;**

**a.** Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj per periudhen **Dhjetor 2019 - Maj 2020**

**b.** Listpagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen **Dhjetor 2019 - Maj 2020**.

**7.Operatoret Ekonomik** duhet te paraqesin ne baze te Udhezimit te agjensise se prokurimit publik dt 25.07.2017 nje analize te cmimit të paraqitur, duke specifikuar sakte të gjithë elementet që kanë marrë parasysh në llogaritjen e cmimit, si dhe duke plotesuar të gjitha kerkesat e VKM 354 date 11.05.2016 si dhe aktet ligjore ne fuqi.

**Në rastet e bashkimit të konsulentëve, kriteret e veçanta të kualifikimit plotësohen bashkarisht nga i gjithë bashkimi.**

**8.**Operatori Ekonomik duhet të zotërojë dhe të paraqesë një çertificate ISO 9001 -2015 (e vlefshme) për menaxhimin e cilësisë lëshuar nga institucione të akredituara për këtë qëllim. (Në rastet e Bashkimit te Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqese certifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizoje sipas marrëveshjes së bashkëpunimit)

**9.**Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Çertifikatë OHSAS 18001-2007,

ekuivalente ISO 45001-2018 (e vlefshme) lëshuar nga institucione të akredituara për këtë qëllim (Në rastet e Bashkimit te Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqese certifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizoje sipas marrëveshjes së bashkëpunimit)

**10** .Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 39001-2012 (per sistemin i menaxhimit të sigurise ne trafikun rrugor) ose ekuivalente lëshuar nga institucione të akredituara për këtë qëllim (Në rastet e Bashkimit te Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqese certifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizoje sipas marrëveshjes së bashkëpunimit).

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

**Shtojca 11**

## DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesemarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë_______________ nga Autoriteti Kontraktor ___________ me objekt ____________________me fond limit __________.

Unë i nënshkruari __________________me cilesinë ___________të operatorit ekonomik ____________________ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____________________është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.

- Operatori ekonomik ___________________ nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara Nenin 45/1 të LPP.

- Personi/at në cilësinë e ***anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik,***si më poshtë:

  ____________________
  ____________________
  ____________________etj.

  nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP[1].

- Operatori ekonomik ___________________ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

- Operatori ekonomik ___________________ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

- Operatori ekonomik ___________________ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomiksi më sipër.**

**Data e dorëzimit të deklaratës _____________**

**Nënshkrimi i ofertuesit ______________**

**Vula ______________**

**Shtojca 11/1**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

**DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE LIGJORE NË MARRËDHËNIET E PUNËS**

Deklaratë e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në proçedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _______________ nga Autoriteti Kontraktor ___________ me objekt _______________me fond limit __________.

Unë i nënshkruari __________________me cilësinë e ___________të operatorit ekonomik __________________, **<u>deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:</u>**

- Operatori ekonomik ________________________garanton mbrojtjen e të drejtës së

punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.

- Operatori ekonomik___________________lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.

- Operatori ekonomik ________________nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Nërastet kur janë konstatuar shkelje ligjore,operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

**Data e dorëzimit të deklaratës _____________**
**Përfaqësuesi i ofertuesit**
**Nënshkrimi**
**Vula**

**Shtojca 12**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

**SPECIFIKIMET TEKNIKE**

Skicimet, parametrat teknik etj:Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë te ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

**Shtojca 13**

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në marrëveshjen kuadër]

## PLANIFIKIMI I<br>KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR

| Shërbim:<br>Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër | | |
|---|---|---|
| **Kontrata Nr.** | **Titulli i Kontratës** | **Përshkrim i shkurtër i kontratës** |
| **01** | | |
| **02** | | |
| **03** | | |
| **…** | | |

**Shtojca 14**

( *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit*)

**SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT**

**Shërbimi që kërkohet:** ***"Studim projektim – "Rikualifikimi Urban i Bllokut qe kufizohet nga rruga Sami Frasheri –Abdyl Frasheri – Deshmoret e 4 shkurtit dhe Dora Distria "***

Afatet e ekzekutimit: 3 (tre) muaj nga data e lidhjes se kontrates.

**Shtojca 15**

**TERMAT E REFERENCËS**

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:***“Studim projektim – ”Rikualifikimi Urban i Bllokut qe kufizohet nga rruga Sami Frasheri Abdyl Frasheri – Deshmoret e 4 shkurtit dhe Dora Distria ”***

BASHKIA
TIRANË

**<u>DETYRË PROJEKTIMI</u>**

**PËR REALIZIMIN E STUDIM-PROJEKTIMIT:**

**"RIKUALIFIKIMI URBAN I BLLOKUT QË KUFIZOHET NGA RRUGA “SAMI FRASHËRI”- “ABDYL FRASHËRI”- “DËSHMORËT E 4 SHKURTIT” DHE “DORA DISTRIA”**

Bashkia e Tiranës, me fondin **4,253,776lekë me tvsh**, kërkon të realizojë studim - projektimin për objektin: *Rikualifikimi urban i Bllokut që kufizohet nga rruga “SamiFrashëri”- “Abdyl Frashëri”- “Dëshmorët e 4 Shkurtit” dhe “Dora Distria””*në NjësinëAdministrative Nr. 5, në qytetin e Tiranës.

## 1. Të dhëna dhe kërkesa të përgjithshme

Ky bllok ndodhet në zonën jugore të qytetit te Tiranës dhe ka një sipërfaqe të përgjithëshme rreth 12.7 ha (127,000 $m^2$) në të cilin dendësia e popullsisë është e lartë. Në këtë zonë ndodhen dy institucione arsimore të rëndësishme si Fakulteti Juridik dhe gjimnazi "Petro Nini Luarasi". Blloku ka një formë të rregullt katërkëndore me përjashtim të një zgjatimi të tij në formë trekëndëshi në pjesën jugore e cila ka mungesë aksesi me rrugët kryesore. Ndërtimet janë kryesisht të reja deri në 10 kate dhe ndërtime të vjetra para viteve ‘90. Ai përshkohet nga një rrjet rrugësh që e ndan atë në shtatë zona. Zonat kanë karakteristika të ngjashme mes tyre duke qënë një kombinim i ndërtimeve të reja e të larta me ndërtime të një periudhe disi më të hershme që kanë lartësi deri në 5 kate.
Blloku i sipërcituar kufizohet nga rrugët "Sami Frashëri", "Abdyl Frashëri", "Dëshmorët e 4 Shkurtit" dhe "Dora Distria".
Ndërhyrja në këtë bllok paraqet rëndësi për zhvillimin urban që ka pësuar kjo zonë në kohët e fundit:

Gjendja e infrastrukturës në këtë bllok paraqitet:

### 1.1 Infrastruktura rrugore

Segmentet kryesore në brendësi të këtij blloku janë rruga “Perlat Rexhepi”, rruga “Janos Hunyadi”, rruga “Milto Tutulani”, rruga “Lidhja e Prizrenit”, rruga “Adem Jashari”, rruga “Vaso Pasha”, të cilat janë të trajtuara me një sens lëvizjeje. Gjendja e këtyre segmenteve rrugore është relativisht e mirë, më e dëmtuar paraqitet një pjesë e rrugës “Adem Jashari” dhe një pjesë e rrugës “Lidhja e Prizrenit”.Në pjesën dërmuese të tyre trotuarët janë në gjendje të shkatërruar ku shtresat e pllakave pothuaj mungojnë ose janë tepër të dëmtuara.Në trotuarë dhe aty ku ka shenja ndërhyrje për përmirësimin e gjendjes, janë përdorur pllaka të përmasave modeleve dhe ngjyrave të ndryshme sipas dëshirës së pronarëve të dyqaneve përgjatë rrugës.Gjithashtu në disa segmente rrugore gjerësia e tyre është e pamjaftueshme për të realizuar qarkullimin normal të këmbësorëve.Bordurat janë tepër të amortizuara, të spostuara dhe të ceduara.Kunetat janë pjesërisht të dëmtuara ndërsa në pjesën më të madhe të rrugëve ato mungojnë plotësisht në të gjithë gjatësinë e rrugës.
Problemi më i madh në këtë zonë, mbështetur në inspektimin e hollësishëm të bërë në terren, janë shtesat e pallateve si dhe shtesat anësore të bizneseve (duke zënë një pjesë të konsiderueshme të trotuareve) duke bërë shumë të vështirë qarkullimin e banorëve si dhe të karrocave të fëmijëve.Pjesa më e madhe e hapësirave midis pallateve është kthyer në parkime automjetesh për rezidentët e zonës duke kufizuar hapësirat rekreative. Hapësirat në brendësi të bllokut kanë nevojë për ndërhyrje rehabilituese dhe mund të përshtaten në hapësira rekreative për banorët. Për trotuare me gjerësi mbi 2 m, të merret në konsideratë gjelbërimi me bimësi të lartë.

### 1.2 Kanalizimet e ujrave të zeza

Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza ekziston, duhet të merret informacion nga UKT për gjendjen funksionale të tyre.

### 1.3 Kanalizimet e ujrave të bardha

Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të bardha ekziston, duhet të merret informacion nga UKT për gjendjen funksionale të tyre.

### 1.4 Rrjeti ujësjellësit

Të verifikohet rrjeti i ujësjellësit. Në rast mungese, të parashikohet ndërtimi i ri i tij.

### 1.5 Rrjeti ndriçimit rrugor

Në disa prej rrugëve të bllokut mungon ndriçimi rrugor i cili duhet të parashikohet të bëhet i ri.

### 1.6 Rrjeti i internet telefonisë

Të verifikohet gjendja e rrjetit të internet telefonisë.

### 1.7 Gjelbërimi

Ky bllok disponon hapësira mjaftueshëm për të parashikuar shtimin e gjelbërimit, i cili mungon.

### 1.8 Mobilim urban

Në të gjithë bllokun, përgjithësisht mungojnë kënde lojërash për fëmijë apo hapësira rekreative për banorët e zonës. Të shikohet mundësia e realizimit të tyre.

**Objekt i projektit do të jetë sistemimi dhe rehabilitimit i bllokut të banimit me të gjithë elementët e infrastrukturës rrugore, me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës së komunitetit të kësaj zone.**

## 2. Kërkesa të projektit

Në këtë zonë, gjatë hartimit të projektit të rrugëve, të mbahen parasysh *Studimet UrbanistikePjesore* (nëse ka), parashikimet e*Planit të Ri Rregullues* dhe *Masterplani i Trasportit.*Gjithashtu, për të përcaktuar saktë kapacitetin për të gjitha shërbimet e kërkuara, duhet patur parasysh koefiçienti i dendësisë së popullsisë, sipas *Rregullores së Urbanistikës* në fuqi si dhe duhen marrë në konsideratë zhvillimet urbane të pritshme dhe në perspektivë të zonës/bllokut në fjalë.

### 2.1 Infrastruktura rrugore

Për trajtimin e rrjetit rrugor, gjerësisë së rrugëve dhe trotuareve, duhet të mbahen parasysh standartet në fuqi ( *Rregullorja e urbanistikës, KTP*).

Shtresat rrugore dhe të trotuarëve të trajtohen të tilla, që të sigurojnë garanci, qendrueshmëri dhe të përballojnë kapacitetet faktike dhe të perspektivës. Shtrimi i trotuarëve do të bëhet me pllaka vetështrënguese dhe me bordura të parafabrikuara. Në pjesët e ndërprerjes së trotuarëve të parashikohet ndërtimi i panduseve të kalimit në nivel rrugë – trotuar për personat me aftësi të veçanta.

Gjatë hartimit të projektit të shikohet mundësia e ndërtimit të parkimeve si dhe vendosja e pikave të VGM në bashkëpunim me drejtoritë përkatëse të Bashkisë Tiranë.Materialet, që do të përdoren, të jenë sipas kushteve teknike të projektimit dhe ndërtimit të rrugëve.

Gjatë hartimit të projektit, projektuesi duhet të konsultohet vazhdimisht me Bashkinë Tiranë përpara fillimit të punës për projektin, ashtu si edhe gjatë të gjitha fazave të projektimit dhe zbatimit të tij dhe kjo si për garantimin e saktësisë së bazës së të dhënave, ashtu edhe për reflektimin e ndryshimeve të pritshme nga plan/studimet e përmendura më sipër.
Përveç saktësisë së të dhënave si më sipër, projektuesi, përpara se të fillojë punën me projektimin duhet, që paraprakisht:

1. Të bëjë relievin (azhornimin) e rrugës; të jepet plani i piketimit (me pikat e forta etj);
2. Të marrë të gjitha azhornimet e rrjetit të infrastrukturës, sipas *formularit 3/1*;
3. Projektuesi duhet të bëjë verifikim paraprak në terren dhe sondime për saktësinë e të dhënave/azhornimeve, për rrjetin e infrastrukturës përpara fillimit të projektimit. Kjo duhet në mënyrë, që të evitohen pasaktësitë gjatë projektimit dhe zbatimit, si rezultat i të dhënave të marra, që nuk përputhen me gjendjen në terren;

Të bëjë studimet përkatëse gjeologjike, hidrologjike etj. (sipas kërkesave të projektimit dhe *formularit 3/1*).

### *2.2 Skema e qarkullimit/lëvizjes*

Projektuesi duhet të hartojë dhe të paraqesë paraprakisht së bashku me skemën e rrjetit rrugor edhe analizën dhe skemën e qarkullimit/lëvizjes në rrugë.Kjo skemë duhet të jetë fletë e veçantëe projektit.

Projekti/skema duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të sigurojnë:

- Aksesibilitetin për të gjitha kategoritë e mjeteve, duke përfshirë rastet dhe mjetet e emergjencës (sidomos ato të zjarrit, shëndetit etj);
- Parashikimin e mënyrës së lidhjes së rrugës me akset kryesore dhe blloqet e banimit kufitarë;
- Aksesibilitetin e këmbësorëve duke i dhënë një përparësi të qartë në rezervimin e hapësirës së lëvizjes si dhe duke parashikuar lidhjen e lëvizshmërisë së tyre në zonë;
- Aksesibilitetin e biçikletave dhe rezervimin e sipërfaqeve për parkimin e tyre (në rast së parashikohet korsi biçikletash);
- Aksesibiliteti i personave me aftësi të kufizuara;
- Shfrytëzimin efektiv të rrugës, parashikimi për parkimin e rezidenteve dhe sidomos parashikimi i vend-parkimit për personat me aftësi të kufizuar;
- Të gjithë elementët e mësipërm të ndërthuren në një projekt sinjalizimi rrugor duke siguruar një organizim të lëvizjes, që përmbush kërkesat si të banorëve ashtu dhe të aktiviteteve të mundshme ekonomike të zonës;
- Plotësimin e elementëve të sigurisë rrugore duke trajtuar me kujdes të gjithë elementët (kalimet këmbësore, këndet e shikimit, ndriçimi, etj.).

## *2.3 Siguria dhe sinjalistika rrugore*

Sinjalistika do të përfshijë sinjalistikën vertikale dhe horizontale për t’i dhënë përdoruesve të rrugëve të bllokut informacionin e duhur për të qarkulluar në mënyrë të sigurt dhe të ligjshme. Për sinjalistikën horizontale do të përdoret bojë speciale bikomponente. Sinjalistika vertikale duhet të pasurohet me të gjitha tabelat e nevojshme (orientimi, lartësia, pozicionimi dhe përmasat e tabelave të sinjalistikës vertikale jepen në Rregulloren e Kodit Rrugor të Shqipërisë (RrKRrSh).Në territore me ndërtime, tabelat duhet të vendosen më lart. Kur ato ngrihen në trotuare apo ku ka levizje këmbësorësh, duhet të lejojne një qartësi të mjaftueshme për këmbësorët: preferohet 230 cm dhe 220 cm si minimum. Pranë kryqëzimeve të vendosen sinjalistikë vertikale për secilën rrugë sipas senseve të orientimit përkatës.

Llojet e sinjaleve rrugore, vertikale dhe horizontale, të vlefshme për përdorim, jepen në Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë (Korrik 1998) dhe “Rregulloren e Zbatimit të Kodit Rrugor Shqiptar” (Prill 2001).

Duhen patur parasysh të gjithë elementët e sigurisë rrugore, ku, sinjalistika është vetëm një komponent i saj. Të merren në konsideratë problemet e mundshme të sigurisë në lidhje me përdoruesit e rrugëve të bllokut, sipas kategorive, ku, hyjnë në mënyrë të përgjithshme elementët për mjetet (dukshmëria, hyrje- daljet nga garazhdet e pallateve dhe tipi i tyre, parakalimi, gjerësia e korsive për qarkullim të përzier të mjeteve, pikave të konfliktit në një kryqëzim etj.) e deri te këmbësorët në mjaftueshmërinë e pikave të kalimit të këmbësorëve dhe krijimin e rampave.

Dhe së fundmi në funksion të planeve të qarkullimit, vendoset sinjalistika përkatëse, e cila përfshin atë vertikale, horizontale dhe semaforike. Hartimi i projekteve për zbatim të sinjalizimit rrugor të jetë sipas planeve urbane me synim standartizimin e kushteve të qarkullimit dhe sigurisë rrugore, në përputhje me rregullat urbanistike dhe me planin e transportit të jetë sipas planeve urbane me synim standartizimin e kushteve të qarkullimit dhe sigurisë rrugore, në përputhje me rregullat urbanistike dhe me planin e transportit.

Të trajtohet në projekt mënyra e lëvizjes si dhe masat e sigurisë së këmbësoreve gjatë punës për realizimin e objektit në të gjitha fazat. Projektuesi duhet të paraqesi në flete të veçanta të gjitha detajet e nevojshme të masave të sigurisë që do të reflektohen edhe në preventiv. Skema e rrjetit rrugor+plani i propozuar i ndërhyrjes për lirimin e sheshit të ndërtimit (prishjet) do të diskutohen me Bashkinë dhe pasi të marrë miratimin e saj, projektuesi vazhdon me detajimin në projekt-zbatimi të rrugës.

## *2.4 Ndriçimi rrugor*

Ndriçimi rrugor duhet të parashikohet të bëhet i ri.

Në rrugë me gjerësi deri në 9m të parashikohet vendosja në njërin krah e shtyllave të reja metalike me lartësi H=7.8m dhe me spesor δ=4mm, ndërsa për rrugë me gjerësi mbi 9m, vendosja e shtyllave të reja metalike me lartësi H=8.8m dhe me spesor δ=4mm, të bëhet në të dy anët e rrugës. Kokat e ndriçuesave do jenë me gradë të lartë rezistence dhe me reflektor alumini me luçidim të lartë i paoksidueshëm, i cili bën në një masë shumë të lartë pasqyrimin e dritës. Hapja dhe mbyllja e xhamit të ndriçuesit lejon një çmontim të shpejtë gjatë mirëmbajtjes. Llampat e ndriçimit do të jenë LED me fuqi 150 Wat deri 250 Wat.

Të respektohen normat Europiane tëperformancës sëndriçimit EN 13201 :

Ndriçuesit të jenë me kontroll smart në mënyrë, që të rregullohet intesiteti i ndriçimit sipas

orëve dhe fluksit tëpërdorimit tërrugës.

Përzgjedhja e normës së ndriçimit sipas PD CEN/TR 13201-1;2014. Të përcaktohet performanca e ndriçimit sipas përdoruesve tërrugës ( makina, biçikleta, këmbësor).
Tëpërcaktohen indikatorët e performancës sëenergjisë:
**2.** Treguesi i densitetit tëfuqisëmetrike (PDI) DP (i matur nëw/(lx m2) dhe
**3.** Treguesi vjetor tëkonsumit tëenergjisë(AECDI) DE (tëmatur në(wh)/m2).

Të përcaktohet lloji i rrugës sipas standartit EN 13201 Urbane, Rurale, Parësore, Dytësore, në mënyrë, që tëpërcaktohet edhe lloji dhe intesiteti i ndriçimit. Jetëgjatësia e ndriçuesit LED sipas standartit IEC 62722-2-1.
Të përcaktohet temperatura e ndriçimit sipas standartit nga 2500 deri 5000 Kelvin, në mënyrë,qëtëevitohet efekti i ndotjes.
Tëpërcaktohen termat e sigurisë,mbrojtja nga tensioni, nga lagështia etj.

Linja të jetë me trase nëntokësore, ku të vendoset tub plastik fleksibël me dy shtresa me Ø=90mm për kalimin e kabllit të furnizimit dhe tub metalik me Ø=110 mm për intersektim rruge. Pusetat të jenë prej betoni me përmasa brenda përbrenda 40x40x40cm me kapak gize.

Distanca ndërmjet pusetave të jetë 25 m larg njëra tjetrës dhe të vendosen mbrapa çdo shtylle për tu mbrojtur nga dëmtimet e makinave.Panelet e komandimit të vendosen me komandim sauteri me fotoelementë.
Të parashikohet dalje energjie në puseta të veçanta për zonat e gjelbërta.
Furnizimi me energji i rrjetit të ndriçimit do të bëhet nga kabinat ekzistuese të zonës. Në këto kabina do të instalohen panelet e ndriçimit rrugor, të cilat do të ushqehen me ura të veçanta nga tranformatori ekzistues. Në kabinë do parashikohet dhe vendosja e matësve të energjisë si dhe tokëzimi i shtyllave të ndriçimit.
Tëparashikohet dhe skema e furnizimit me energji elektrike për ndriçimin rrugor.

## *2.5 Kanalizimet e ujërave të zeza dhe ujërave të shiut*

Qyteti i Tiranës kohët e fundit ka pësuar ndryshime të dukshme në drejtim të shtrirjes së ndërtimeve duke ndjekur dy drejtime kryesore, të cilat në funksion te zhvillimit të tyre kanë sjellë probleme në rrjetin e kanalizimeve. Si drejtim i parë është rritja e intensitetit të ndërtimeve në zonat ekzistuese të ndërtimit dhe drejtimi i dytë është zhvillimi i ndërtimeve në zona pothuajse të pazhvilluara më parë. Të dy rastet sjellin, si rezultat rritjen e sasive të ujërave të zeza dhe ujërave të shiut, respektivisht për shkak të rritjes së konsumit të ujit në zonë dhe rritjes së rrjedhës së ujrave të shiut.

Të nisur nga sa më sipër gjatë hartimit të projekt-zbatimit duhen parashikuar:
1. Të merret në konsideratë perespektiva 20 vjeçare e rritjes së popullsisë.
2. Të merret në konsideratë ruajtja e rrjetit ekzistues që ka kapacitetin e mjaftueshëm përcjellës dhe është në gjendje të mirë punë. Informacion më i detajuar duhet të merret pranë Sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Tiranë.
3. Drejtimi i zhvillimit urbanistik të zonës do të merret në Bashki.
4. Të merret në konsideratë “Studimi i Planit të zhvillimit të sistemit të kanalizimeve” kryer nga firma “JICA” dhe studimet pjesore të miratuara në zonën në fjalë.

Nëse është e mundur sistemi i largimit të ujrave të bardha dhe të zeza të jetë i ndarë, në të kundërt të ruhet sistemi miks.

**Sasitë e ujit, që derdhen në sistemin e kanalizimeve.** Për sasitë e ujërave të zeza, qëderdhen në sistemin e kanalizimeve rekomandohet të përdoren të dhënat sipas “Studimi i

Planit të zhvillimit të sistemit të kanalizimeve” kryer nga firma “JICA” për qytetin e Tiranës si më poshtë:

Q.mes dit.= 194 l/ditë/banorë
Q.max orë= 437 l/ditë/banorë

Për sasitë e ujrave të shiut do të përdoren të dhënat e Institutit Hidrometeorologjik dhe mënyra e llogaritjes do të paraqitet nga projektuesi në mënyrë të argumentuar.

**Siguria llogaritëse,** Siguria llogaritëse e ujërave të shiut do të llogaritet 25 % për kolektorëtkryesorë dhe 40 % për kolektorët sekondarë.
Vlera e llogaritjes së shiut të merret për periudhë përsëritje 1 herë në vit dhe kohëzgjatje prej 15 minutash. Intensiteti për Tiranën është 150-170litra/sek/ha, e cila del me llogaritje.

**Materiali kryesor ndërtimor,** për kanalizimin do të jetë përdorimi i tubave prej politileni tëbrinjëzuar të llogaritura për të përballuar ngarkesat ose tubacione betoni me gota, pusetat dhe nënobjektet e tjera do të jenë me material betoni të armuar duke eleminuar përdorimin e materialit të tullës në sistemin e kanalizimeve, që ka rezultuar me probleme. Megjithatë projektuesi do të argumentojë materialet që do të përdoren për çdo nën objekt. Pusetat duhet të jenë të pajisura me shkallë metalike.
Për rrjetin e kanalizimeve të ujërave të shiut do të përdoren *puseta betoni me zgarë me kapakme material kompozit.*

### *2.6 Ujësjellësi*

Në bashkëpunim me Ujësjellës–Kanalizime sh.a.do të saktësohet dhe gjendja e ujësjellësit ekzistues, projektet, që ka kjo ndërmarje, si dhe problemet e vërejtura në këtë zonë gjatë periudhës së furnizimit me ujë me rrjetin ekzistues të ujësjellësit. Norma e furnizimit e rekomanduar do të jetë 150 l/ditë/banor. Materialet, që do të përdoren për tubacionet e ujësjellësit do të jenë tuba polietileni HDPE-100 për 10 atm, që plotësojnë normativat në fuqi, kanë përbërjen kimike dhe aftësinë mbajtëse ndaj presioneve të llogaritura. E njëjta gjë vlen edhe për pajisjet hidraulike dhe aksesorët.Saraçineskat dhe pajisjet e tjera hidraulike, që do të përdoren duhet të jenë Pn=16 atm. Për nyjet do të parashikohen puseta me kapak b/a, përmasat e të cilave duhet të realizohen sipas kushteve teknike dhe të sigurojnë kushte normale manovrimi dhe riparimi. Pusetat duhet të jenë të pajisura me shkallë metalike në rastet kur janë të thella.
Për lidhjet e banesave me tubacione me diametër më të vogël se 2” sugjerohet të përdoren puseta komandimi me aks vertikal.Të verifikohen nga projektuesi në bashkëpunim me UKT vendi i kasetave për sahatët e matjes së ujit, pasi shpesh herë ato gjenden në muret rrethuese të objekteve, të cilat mund të llogariten për t’u prishur për zgjerimin e rrugëve, dhe të llogariten punime përkatëse për spostimin e tyre.

### *2.7 Hidrantët zjarrfikës*

Gjatë fazës së hartimit të projektit projektuesi duhet të parashikojë vendosjen e hidrantëve zjarrfikës, referuar normave të miratuara në fuqi dhe rregullores së PMNZSH-së.

### 2.8 Hapësira urbane

Përveç skemës së rrjetit rrugor (projektit të rrugës dhe trotuarëve), projektuesi duhet të trajtojë me projekt zbatimi, ***të gjitha hapësirat e lira urbane që krijohen/mbeten ngabordura e trotuarit deri në kufirin e ndërtimeve***, godinave përgjatë rrugëve ose në brendësitë blloqeve (pra deri në rrezen e objekteve përgjatë rrugës dhe në brendësi të bllokut); trajtimi

i tyre të bëhet me elemente të rikualifikimit urban (shtrim, etj), përveç elementëve të gjelbërimit të lartë apo të ulët sipas rastit dhe specifikave të vendndodhjes.

Do të jenë fletë të veçanta të projektit, trajtimi dhe detajimi teknik (faza/projekt zbatim) për secilin prej këtyre elementëve të hapësirës urbane.

Sa më sipër, projektuesi duhet të identifikojë në terren të gjitha hapësirat e tjera urbane, të lira ose që lirohen nga projekti, të cilat janë të përshtatshme të planifikohen për ndërhyrje të rikualifikimit urban, të tilla që krijojnë sheshe të vogla brenda bllokut të banimit, ku mund të akomodohen funksione të tilla si ambiente shplodhëse (me stola etj) për moshën e tretë dhe banorët e bllokut, sipërfaqe të gjelbërta, kënde të vogla lojrash për fëmijë, terrene sportive (minikalçeto, basketbolli, skateboarding), etj. Lodrat e fëmijeve të cilat do të propozohen nga projektuesi duhet të jenë të forta dhe të inkastruara mirë për të evituar dëmtimet dhe vjedhjet. Në preventiv, projekt dhe në specifikimet teknike të jepen informacion i plotë për materialin e tyre, si dhe detaje për vendosjen e tyre në objekt.
Një vëmendje të veçantë në projekt, projektuesi duhet t'i kushtojë edhe elementëve të mobilimit urban (ose kur është rasti edhe të artit urban) që do të propozojë të përdoren përgjatë të gjithë rrugë, si: stola, kosha të mbeturinave, vendin e vendosjes së konteinerëve dhe të largimit publik të mbeturinave (përcaktimi i tyre të bëhet në bashkëpunim me Drejtorinë e Pastrimit në Bashki), zgara apo rrethime të pemëve, kangjella kufizuese në trotuare (kur është rasti) si dhe bllokues të mjeteve në trotuare, zgarat për biçikletat, etj.
Koshat për hedhjen e mbeturinave duhet të jenë të komandueshme për tu pastruar lehtësisht nga shoqëritë përkatëse të pastrimit, dhe kjo duhet të specifikohet në projekt ne detajin përkatës.
Të verifikohen dhe të parashikohen lidhja e ullukëve të shkarkimit të tarracave me pusetat K.U.SH.të rrugëve, duke parashikuar punime për t'i kaluar nën nivelin e trotuareve të rrugës dhe lidhjen e tyre deri në pusetën K.U.SH. më të afërt. Detaje teknike të ndryshme për ndërhyrjet, që do të propozohen. Projektuesi duhet të trajtojë këto elementë në fazën e projektit të zbatimit (me të dhëna të plota për furnizim-vendosje), ku të përcaktojë detaje tip, frekuencën e vendosjes, skemën e shpërndarjes së tyre, llojin e materialit, detaje të inkastrimit, sasinë, zërin në preventiv etj.
Terrenet sportive të cilat do të propozohen në hapësirat urbane duhet të jenë të përcaktuar për çfarë do të shërbejnë (minikalçeto, basketbolli, skateboarding, etj) dhe në preventiv të jenë parashikuar dhe elementët dhe pajisjet përkatëse, si kosha, tabela, tapeti etj. Kjo për të evituar kthimin e tyre në hapësira boshe dhe pa funksion.Për hapësirat e identifikuara si të tilla (si në rastet kur kërkojnë prishje të ndërtimeve pa leje ekzistuese dhe në rastet kur janë të lira), projektuesi do të hartojë paraprakisht një skemë të shpërndarjes së këtyre hapësirave në territor, si dhe të projekt-idesë së tij për zgjidhjen funksionale të tyre dhe projekt-idenë teknike. Pasi ta ketë diskutuar dhe marrë miratimin paraprak të Bashkisë, do të hartojë për to projektin e plotë teknik dhe të zbatimit.

Projektuesi do të paraqesë secilën nga këto hapësira si një nënprojekt (me të gjitha detajet teknike dhe fletët, si të ishte një projekt-zbatimi i veçantë, përfshirë edhe preventivin). Në trajtimin e hapësirës, përjashtohen objektet sociale.

***Projektuesi do të japë zgjidhje dhe për vaditjen e sipërfaqeve të gjelbërta të bllokut, sigurimin e burimit të ujit. Kjo e shoqëruar me projektin dhe preventivin përkatës.***

### *2.9 Rrjeti Internet-Telefonisë*

Të ndërtohet rrjeti i tubacioneve shpërndarëse të internet – telefonisë, sipas standarteve të përcaktuara duke marrë në konsideratë numrin e operatorëve operues në zonë, numrin e komunitetit përfitues, si dhe zhvillimin në prespektivë të këtij shërbimi, për një periudhë kohore 10 vjeçare. Ky rrjet duhet të shtrihet në të gjithë akset rrugore kryesore dhe sekondare si dhe të ketë ndërlidhje me rrjetin ekzistues në zonat kufizuese rreth bllokut (ajror ose nëntokësore). Duhet të respektohet standarti i rregullores Nr. 22 AKEP, mbi kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve kabllore urbane dhe rrjeteve me fibra optike ndërurbane të komunikimeve elektronike.

### *2.10 Parkimet*

Rekomandohet të parashikohet ndërtimi i parkimeve referuar rregulloreve dhe hapësirave faktike, si dhe të lihet hapësirë për hyrjen dhe daljen lirshëm nga garazhdet e pallateve.

## 3. Fazat e zbatimit

Për efekt të fondit të zbatimit, të realizimit të prishjeve (të mundshme) si dhe të efiçencës së ndërhyrjes, projektuesi duhet t’i rekomandojë investitorit fazat e realizimit në kohë (ose sipas elementëve te ndryshëm) të projektit.
Projektuesi mund t’i rekomandojë Investitorit, që projekti të realizohet në disa faza ose lote, si dhe sipas elementëve të ndryshëm të tij (psh. rrjetit rrugor dhe infrastruktura/punime ndërtimi, apo mobilimi urban/furnizim, vendosje).
Lidhur me këtë fakt, projektuesi do të propozojë fazat e realizimit të projektit, ku të dhenat (si fletët e projektit, preventiva, grafiku i punimeve) për çdo fazë duhet të jenë të konceptuara ose të organizuara, që të lehtësojnë Investitorin në organizimin e zbatimit (buxhetim, prokurim, kontraktim për zbatim) të projektit me faza.

## 4. Standardet

### *4.1 Standarde në projektim*

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standartet për projektim, që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standarteve, madje edhe atyre gjatë zbatimit.Është përgjegjësi e projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standarteve dhe normave përkatëse.

Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standareve të reja, për përafrimin me normat e BE-së, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim.Rekomandimet duhet të përmbajnë elementë të fizibilitetit dhe realizueshmërisë me praktikën shqiptare dhe limitimet për financimin e veprës.

Në hartimin e projektit të mbahen parasysh të gjitha normat e miratuar për PAK (personat me aftësi të kufizuar).Në projekt të parashikohet infrastruktura e nevojshme për këtë kategori.

Detajet teknike të infrastrukturës për këtë kategori, të jepen nga projektuesi në fletë të veçanta të projektit.

### *4.2 Standarte në paraqitjen e dokumentacionit teknik*

Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, projektuesi të përdorë programet e kërkuara kompjuterike, si dhe të nxitet përdorimi i programeve të reja, me të avancuara të fushës.

Në hartimin, paraqitjen dhe miratimin e dokumentacionit teknik të projektit të parashikohet dhe të respektohen të gjitha kërkesat dokumentare dhe të paraqitjes që parashikon Ligji "Për urbanistikën", Rregullorja e Urbanistikës dhe Legjislacioni në fuqi.

## 5. Realizimi i projektit

Realizimi i projektit **"Rikualifikimi urban i Bllokut që kufizohet nga rruga "SamiFrashëri"- "Abdyl Frashëri"- "Dëshmorët e 4 Shkurtit" dhe "Dora Distria"do tëmbështetet në fazat e VKM Nr. 354, datë 11.05.2016,** duhet të kalojë në këto faza:

**FAZA IAnaliza e detyrës së projektimit**

Analiza e detyrës së projektimit/termave të referencës dhe përcaktimi i bazës së projektit (format A4); Vëzhgimi dhe mbledhja e dokumenteve fartografike për zonën në të cilën duhet ndërhyrë - ( formati A3/A2).
Materiali grafik i përgatitur nga konsulenti duhet të përfshijë:

-Pozicionimi në hartat;
-Kryqëzimet;
-Përshkrimi i situatës aktuale;
-Verifikimi i projekteve të miratuara për zonën objekt studimi etj.

Fletët grafike do të përgatiten bazuar në vrojtimin; ato duhet të jenë lehtësisht të lexueshme dhe të kuptueshme.

**Materialet dorëzohen në 1 kopje format hard copy ( të printuar) dhe 1 cd në format soft copy ( cad,exel,word).**

**FAZA II Projekt ide paraprake (Përgatitja e projektit dhe planifikimit).**

**Përpunimi pjesëve të rëndësishme të një zgjidhjeje të detyrës së planifikimit, e cila do paraqitet në jo më pak se 2 variant-propozime, ku për secilin variant do dorëzohet:**

1. Analiza e aksesibilitetit dhe zonimit, referuar Planit Lokal
2. Vlerësimi i ndërtimeve ekzistuese (evidentimi i objekteve që prishen/ruhen)
3. Vizatimet teknike :planimetri të përgjithshme, prerje tip të rrugëve, në një shkallë të lexueshme;
4. Analiza dhe propozimi për qarkullimin e automjeteve dhe vendet e parkimit; konceptet e transportit
5. Relacion teknik (mbi ndërhyrjet e parashikuara);
6. Preventiv paraprak.

Varianti me treguesit më social - ekonomik dhe teknik, që do të përzgjidhet nga Këshilli Teknik, do të vazhdojë procedurën e hartimit të projekt-idesë përfundimtare.

(Të paraqiten variantet e propozuar me preventivat paraprake e specifikimet përkatëse duke përfshirë dhe kostot e shpronësimeve, nëse ka, për secilin variant).

**Materialet dorëzohen në 1 kopje format hard copy ( të printuar) dhe 1 cd në format soft copy ( cad,exel,word).**

**FAZA IIIProjekt ide përfundimtare (planifikimi i sistemit dhe i integrimit)**

**Përpunimi i zgjidhjes përfundimtare të detyrës së planifikimit.**

Në këtë fazë konsulenti duhet të përgatisë projekt idenë përfundimtare të ndërhyrjeve, pas miratimit në Këshill Teknik të variantit socio-ekonomik dhe teknik më të përshtatshëm të miratuar në fazën e projekt idesë-paraprake, e cila duhet të përmbajë:

a. Raport teknik;
b. Preventivin e punimeve sipas formatit të miratuar nga Bashkia Tiranë, referuar VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimevetë ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”;
c. Analizat teknike të çmimeve, për zërat, që nuk ndodhen në VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimitdhe të analizave teknike të tyre”;
d. Vizatimet teknike për të gjitha punimet e parashikuara me detajet përkatëse;
e. Specifikimet teknike për zërat e punimeve, që do të kryhen;
f. Grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të punës;
g. Rilevimi;
h. Studimi gjeologjik.

***Materialet dorëzohen ne format hard copy (të printuar) dhe cd në formate soft copy (cad,exel,word etj.)***

Pranë Drejtorive përkatëse të Bashkisë dhe institucioneve në varësi, kryhet aplikimi, nga ana e operatorit ekonomik të kontraktuar për hartimin e studim-projektimit, për vendosjen në dispozicion të informacionit në lidhje me azhornimet inxhinierike, statusin juridik të pronës etj.

**FAZA IV: Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit: Përpunimi dhe dorëzimi i dokumentave për procedurat e nevojshme juridike e ligjore.**

Projektuesi gjithashtu duhet të parashikojë dhe projektin për miratimin e lejes së ndërtimit, i cili duhet të mbështetet në ligjin Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”.Për këtë për çdo dokumentacion të nevojshëm për hartimin e projektit si dhe për aplikimin për leje ndërtimi përmes portalit të Regjistrit të Integruar të Territorit, të bashkëpunohet me Drejtoritë përkatëse të Bashkisë Tiranë.

**FAZA V:Projekti zbatimit: Përpunimi dhe paraqitja e planit të zgjidhjes së gatshmepër zbatim.**

Dosja e plotë e projektit të zbatimit për objektin: **“"Rikualifikimi urban i Bllokut qëkufizohet nga rruga “Sami Frashëri”- “Abdyl Frashëri”- “Dëshmorët e 4 Shkurtit” dhe “Dora Distria”"** do përmbajë:

1. Raporti teknik;
2. Raporti përfundimtar teknik përfshin të gjitha informacionet në lidhje me projektin, duke shpjeguar arsyet në të cilat u bazua skema e detajuar e projektit. Ai përshkruan analizën e bërë nga projektuesi për situatën dhe projektin e propozuar. Raporti të sigurojë të dhëna të sakta, bazuar në testet / vlerësimet ekzistuese, llogaritjet e bëra, llogaritja e shtresave rrugore, ndriçimit, etj., masat inxhinierike që parashikohen të merren, etj. Në raportin teknik do të përfshihet raport arkitektonik, raport strukturor, elektrik, hidro etj., si dhe studimet mbështetëse (vlerësimet topografike, gjeologjik dhe materiale, raport hidrologjik dhe hidraulik, etj.);
3. Llogaritjet statike të strukturave (në rast kur kemi parashikuar mure mbajtëse;
4. Llogaritjet e shtresave, të dhëna të sakta bazuar në teste për gjendjen ekzistuese, masat inxhinierike, që jane parashikuar të merren, siguria e kalimit në rrugë dhe masat që duhet të merren për rregullimin e trafikut gjatë punimeve të ndërtimit dhe specifikimet teknike për cdo zë pune;
5. Metoda e llogaritjes së shtresave të jetë e bazuar në CBR;
6. Hartimi i relievit topografik të bllokut (koordinata lokale, kuota absolute);
7. Pasqyrimi në projekt i azhornimeve të rrjetit ekzistues të ujësjellësit, rrjetit të kanalizmeve të ujërave të shiut dhe të zeza, rrjetit të elektrikut dhe internet – telefonisë;
8. Raport gjeologjik;
9. Analizë e situatës ekzistuese dhe të prishjeve të ndërtimeve pa leje (nëse ka);
10. Tabela volumetrike e prishjeve;
11. Planimetrinë dhe raporti i shpronësimeve
12. Planet e shpronësimit duhet të përfshijnë planin e zonave kadastrale dhe sipërfaqeve përkatëse, të konfirmuara nga ZRPP;
13. Skemën e qarkullimit në rrugë;
14. Projektin e zbatimit të trasesë së rrugës;
15. Kuotat e pusetave ekzistuese (koka e tubit, diametri i tubit);
16. Profilin gjatësor të rrugëve;
17. Profilat tërthorë të rrugëve;
18. Profilat tip të seksionit tërthor të rrugëve;
19. Detajet e ndryshme të trotuarit, bordurave, etj;
20. Projektin e zbatimit të rrjetit të kanalizimeve të largimit të ujrave të shiut;
21. Studimi hidrologjik për të përcaktuar hidromodulin e zonës në studim;
22. Analizat dhe llogaritjet e rreshjeve në zonë;
23. Llogaritjet e shkarkimit maksimal të ujërave;
24. Projektin e zbatimit të rrjetit të kanalizimeve të ujrave të zeza;
25. Projektin e zbatimit të rrjetit të ujësjellësit përfshirë dhe detajet e pusetave të pajisjeve dhe rakorderive të nyjeve, etj;

- Projektin për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi, në vendosjen e hidrantëve zjarrfikës mbështetur në normat në fuqi;
- Projektin dhe planet e ndricimit rrugor dhe dekorativ;
- Skema e furnizimit me energji elektrike dhe detajet përkatëse;

29. Llogaritja dhe skema e paneleve elektrike;
30. Projektin e zbatimit për ndërtimin e rrjetit të linjave rezervë;
31. Sinjalistikën rrugore horizontale dhe vertikale dhe parkimet;
32. Specifikimet Teknike për zërat e punimeve që do të kryhen;
33. Kontraktuesi duhet të përgatisë specifikimet teknike për secilën material që do të përdoret. Për secilën punë të përfshirë në preventiv, duhet të bëhet analiza sipas kësaj skeme:

- Përshkrimi i detajuar i procesit të punës;
- Metoda e vendosjes;
- Cilësia e kërkuar;
- Format e miratuara;
- Ngjyra e rekomanduar;
- Skica, vizatime ose foto

34. Preventivin e punimeve mbështetur në manualet teknike të çmimeve në fuqi;
35. Grafikun e punimeve të ndërtimit;
36. Plan organizimin e punimeve dhe ngritjen e kantierit në funksion të mjeteve, që do të jenë pjesë e realizimit të objektit, mbështetur dhe në grafikun e punimeve;
37. Raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM);
38. Liçensë të firmës projektuese, liçensë të ekspertit mjedisor dhe ekstrakt i rregjistrit tregtar.
39. Deklaratat e përgjegjësisë profesionale të firmës projektuese dhe stafit**;**

***Materialet dorëzohen në 5 kopje format hard copy ( të printuar) dhe 5 cd ( 4 cd në format soft copy cad,exel,word etj dhe 1 cd në format pdf).***

**<u>FAZA VI:</u>Hartimi i preventivit përfundimtar**

Për hartimin e preventivit projektuesi duhet të mbështetet në VKM NR.629, datët.15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre".
Për secilin zë punimi, i cili nuk është i përfshirë në këtë manual, projektuesi duhet të dorëzojë analizat/ofertat përkatëse të çmimeve.
Në hartimin e preventivit, veç të tjerave do të mbahen parasysh sa më lart, lidhur me organizmin e zbatimit me faza, çmimet e referencës sipas akteve ligjore në fuqi, dhe llogaritja e preventivit do të bëhet sipas normave dhe akteve ligjore në fuqi për të siguruar kursimin dhe efiçencën e përdorimit të fondeve.
Preventivi do të hartohet sipas formatit/modelit standart të rekomanduar nga Bashkia Tiranë.

## 6. Rekomandime për projektuesin

**a)** Projektuesi duhet të përdorë dhe të rishikojë të gjithë informacionin ekzistues lidhur me rrugën. Projektuesi duhet të hartojë, përveç projektit përfundimtar dhe një projekt teknik i cili duhet të analizojë rast pas rasti të gjitha prishjet e mundshme për të realizuar me faza këte investim.
**b)** Projektuesi duhet të përdorë studimet dhe të dhënat paraprake, që disponohen nga Bashkia e Tiranës, seksioni i Urbanistikës dhe nga Kadastra. Në hartimin e projektit duhet të merren në konsideratë edhe standarte të ndryshme, që ka nxjerrë Bashkia e Tiranës, siç janë p.sh. tipi i kollonave të ndriçimit, llojet e ndriçuesve e të tjera të kësaj natyre.

**c)** Grupi i projektimit përveç rrjetit rrugor dhe të infrastrukturës nëntokësore, duhet të trajtojë dhe hapësirat e brendshme të bllokut, si zonat e gjelbërta, terrenet sportive, këndet e lojërave për fëmijë etj.
**d)** Në projekt të parashikohet mundësia e krijimit të fasiliteteteve për PAK.

## 7. Paraqitja e vizatimeve

Vizatimet e projektit duhet të përmbajnë minimalisht fletët si mëposhtë:

1. Horografia
2. Topografinë e gjendjes ekzistuese, në të cilën të jenë të azhornuara të gjitha ndërtimet në gjendjen e sotme (me leje dhe pa leje) në Shk. 1:500 ose 1:1000;
3. Planimetria e sistemimit të rrugës në Shk. 1:500 ose 1:1000;
4. Planimetria e prishjeve në shkallë 1:500;
5. Profilet gjatësorë të rrugëve Shk. 1:1000, 1:100;
6. Profilet tërthorë të rrugëve jo më pak se 25 m;
7. Detaje konstruktive tip të shtresave të rrugës, trotuarëve, pusetave, etj.;
8. Kryqëzimet dhe detaje përkatëse;
9. Planimetria e rrjetit të kanalizimeve në shkallën 1: 500;
10. Profilat gjatesorë të rrjetit të kanalizimeve në Shk. H1:1000,V1:100;
11. Puseta dhe detaje të tjera të rrjetit të kanalizimeve;
12. Planimetria e rrjetit të ujësjellësit në shkallën 1: 500;
13. Profilat gjatësorë të rrjetit të ujësjellësit në Shk. H1:1000,V1:100;
14. Pusetat, detajet e nyjeve dhe lidhjeve si dhe detaje të tjera të rrjetit të ujësjellësit;
15. Planimetri dhe detaje për lëvizshmëri/sinjalistikën rrugore;
16. Planimetria e hapësirave publike dhe mobilimit urban;
17. Detaje teknike të mobilimit urban;
18. Planimetria e ndriçimit rrugor dhe detaje të ndriçimit rrugor;
19. Planimetria e tubacioneve të rrjetit të internet telefonisë në shkallë 1:500;
20. Profilet gjatësore të rrjetit të internet telefonisë në Sh: H 1:1000, V 1:500;
21. Detaje të mënyrës së vendosjes së PVC, të rrjetit të internet telefonisë dhe intersektimit me rrugët SH 1:25;

Të gjitha fletët e vizatimeve duhet të jenë të detajuara me elementët përkatës, si dhe legjendat përkatëse.

## 8. Raportimi dhe dorëzimi final

Dorëzimi final, fizik, i projektit të zbatimit, do të konsiderohet ai, i cili do të ketë kaluar njëherë të gjitha fazat e mësipërme dhe në rast se preventivi i projekt-zbatimit do të ketë vlerë të barabartë apo më të madhe se 100,000,000 lekë më t.v.sh., projekti do t'i nënshtrohet oponencës teknike të Institutit të Ndërtimit, sipas afateve përkatësë. (të miratuara përkatësisht nga Këshilli Teknik i Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve Publike).
Ne afatet e dorëzimit përfshihet dhe koha 1 javore per komentet e klientit për secilën fazë.
Dorëzimi i dokumentacionit do të bëhet në rrugë zyrtare shoqëruar me fletë inventari. Të gjitha dokumentat e printuara duhet të jenë të firmosura e vulosura në origjinal nga të gjithë projektuesit.
***Materialet dorëzohen në 5 kopje format hard copy (të printuar) dhe 5 cd (4 cd në format soft copy cad,exel,ëord etj, dhe 1 cd në format pdf)***
Gjithashtu do dorëzohet versioni i dixhitalizuar i cili transferohet në GIS.

## 9. Investimi Themelor

Investimi themelor do të dalë nga varianti më i mirë i miratuar nga Këshilli Teknik i Bashkisë së Tiranës.

## 10.Sqarime të fundit

Projektuesi është përgjegjës të sigurojë saktësinë dhe pajtueshmërinë me të gjitha standardet dhe normat përkatëse.
Të dhënat e nevojshme për projektim, sikurse janë: gjendja e rrjetit ekzistues të ujësjellësit, të kanalizimeve, ndriçimit, kabinat e tensionit të lartë, vendosja e kontenierëve, planin rregullues të zonës, etj, do të merren nga projektuesi sipas formularëve përkatës.

**ORTOFOTO E OBJEKTIT**



Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve:

Njesia Adm nr.5 , Tiranë

**Shtojca 16**

[ *Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

**NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR[1]**

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” .

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u skualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

____________________________________________________________________________
____________________________________________________________________________
____________________________________________________________________________
____________________________________________________________________________
____________________________________________________________________________
____________________________________________________________________________
____________________________________________________________________________

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
**< Emri >**

**Shtojca 17**

[ *Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

[Data________]

Për: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]*

Procedura e prokurimit:
Numri i referencës së procedurës/lotit:
Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]*
Publikime të mëparshme *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*

* * *

Lista e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës së sipërcituar:

1.___________________________________ ______________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

2.___________________________________ ______________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*
Etj.

* * *

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës nëfazat e tjera të procedurës së sipërcituar këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1.___________________________________ ______________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*
Vlera ______________________________
*(me numra dhe fjalë)*

2.___________________________________ ______________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera ____________________________

*(me numra dhe fjalë)*

Etj.

Janë skualifikuar operatorët ekonomikëtë mëposhtëm:

1.________________________________ ____________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

2.________________________________ ____________________________

*Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it*

Etj.

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë ***[emri, Nipti dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]*** se oferta e paraqitur nga ana juaj dhe e vlerësuar me ______pikë, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _________nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) siç parashikohet në nenin 49 të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë ____________________

Ankesa: ka ose jo_____________

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë ________________________

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**

**Shtojca 18**

[ *Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër*]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR**

*[Data]*

Për: *[Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]*
1.__________________________________________
*2.* __________________________________________
*3.*__________________________________________

* * *

Procedura e prokurimit: ______________________
Numri i referencës së procedurës/lotit:
Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*
Publikime të mëparshme *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*
Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:   oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1.__________________________________  ______________________________
*Emri i plotë i shoqërisë*  *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera ______________________________
*(me numra dhe fjalë)*

2.__________________________________  ______________________________
*Emri i plotë i shoqërisë*  *numri i NIPT-it*
Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____________________________
*(me numra dhe fjalë)*

Etj.____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1.__________________________________ ______________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*
2.__________________________________ ______________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:
________________________________________________________________________________
________________________________________________________________________________
________________________________________________________________________________

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se jane identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:
1.__________________________________ ______________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _______________/ Pikët totale të marra ____
*(me numra dhe fjalë)*
2.________________________________ ______________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera ___________/Pikët totale të marra ____
*(me numra dhe fjalë)*
Etj.__

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]*, brenda ____________ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë ______________________________

Ankesa: ka ose jo______________
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë ___________________________

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**

**Shtojca 19**

## KUSHTET E PËRGJITHSHME TE KONTRATES
### Shërbimet e Konsulencës

### Neni 1 Qëllimi

1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për Shërbimet e Konsulencës.

1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërise parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.

1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.

1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.

Kushtet e kontratës, përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

### Neni 2 Përkufizime

2.1 “Kontratë” do të thotë marrveshja e shkruar e lidhur midis Blerësit Publik dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

2.2 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.

2.3 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.

2.4 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.

2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen sherbimin. Ky term kudo qe përdoret ka kuptim të njëjtë me ate te perkufizuar ne ligj.

2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.

2.7 “Shërbime” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.

2.8 “Termat e References” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojne detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

**Neni 3 Hartimi i Kontratës**

3.1 Shpallja e fituesit do të sherbejë per hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.

3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke materializuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

**Neni 4 Praktikat Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

4.1 Autortiteti Kontraktues mund t’i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën në se zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.

4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në pregatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.

4.3 Kontraktuesi është dakort që të përjashtojë veten e tij nga prokurimi i mallrave, shërbimeve ose ndertimeve që mund të pasojnë, si rezultat i, ose në lidhje me, këtë kontratë.

4.4 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe procesverbalet që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

**Neni 5 Informacioni Konfidencial**

5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në kofidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.

5.2 Kontraktuesi mund t’i japë nenkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktues deri në masën e kërkuar për nën-kontraktuesin në mënyrë që ai të kryejë punën e tij sipas kontatës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktuesin një dispozitë që premton ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

**Neni 6 Prona Intelektuale**

6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë Kontrates do t’i përkasin Autoritetit Kontraktues i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.

6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Furnizuesi, pas përfundimit

të kontratës, duhet t’i dorëzojë Autoriteti Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose pregatitura nga Kontraktuesi gjatë kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t’i përdori për qëllime që s’kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.

6.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktues nga mospërgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose kryerja e Shërbimeve sipas kontratës.

6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoriteti Kontraktues në lidhje më ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i gjërave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t’i japë Autoriteti Kontraktues të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

**Neni 7 Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit**

